



REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA

K.DH.SH.II.nr.1024/2023

GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS – Dhomat e Shkallës së Dytë, me gjyqtarin individual Ramush Bardiqi, në çështjen juridike përmbare të kreditorit “4 M” SH.P.K., me seli në Prishtinë, Bulevardi “Nënë Tereza” 32-1, nr.5, të cilin e përfaqëson F. S., avokat nga Prishtina, kundër debitorit “Chelsea Point” L.L.C., me seli në Prishtinë, rr.“Tringë Smalji” 12/4, të cilin sipas autorizimit e përfaqëson K. P., avokat nga Prishtina, me bazë juridike përmbare për pagesën e borxhit, duke vendosur lidhur me ankesën e të autorizuarit të kreditorit, të paraqitur kundër aktvendimit të Gjykatës Komerciale, Dhomat e Shkallës së Parë, Departamenti për Çështje Ekonomike KPPP.nr.831/2022 të datës 28.04.2023, me datë 02.11.2023, mori këtë:

A K T V E N D I M

REFUZOHET si e pabazuar ankesa e autorizuarit të kreditorit “4 M” SH.P.K., me seli në Prishtinë, Bulevardi “Nënë Tereza” 32-1, nr.5, ndërsa aktvendimi i Gjykatës Komerciale, Dhomat e Shkallës së Parë, Departamenti për Çështje Ekonomike KPPP.nr.831/2022 i datës 28.04.2023, VËRTETOHET.

A r s y e t i m

Gjykata Komerciale, Dhomat e Shkallës së Parë, Departamenti për Çështje Ekonomike, me aktvendimin e ankimuar KPPP.nr.831/2022 të datës 28.04.2023, ka aprovuar si të bazuar propësimin e debitorit “Chelsea Point” L.L.C., me numër të biznesit 70772469, ka anuluar urdhrin përmbare P.nr.564/2017 të lejuar me datë 17.10.2017, nga Përmbareuesi Privat Kushtrim Metaj, dhe ka përfunduar në tërësi përmbaremin në këtë çështje përmbaremore.

Kundër këtij aktvendimi, në afatin ligjor, ankesë ka paraqitur i autorizuari i kreditori për shkak të vërtetimit të gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike dhe aplikimit të gabuar të së drejtës materiale, me propozim që të aprovohet ankesa në tërësi si e bazuar, të ndryshohet aktvendimi i ankimuar, të lihet në fuqi urdhri përmbare P.nr.564/2017 i datës 17.10.2017 dhe të detyrohet debitori që t'i paguaj shpenzimet procedurale.

Përgjigje në ankesë nuk ka paraqitur debitori.

Gjykata Komerciale – Dhomat e Shkallës së Dytë, përmes gjyqtarit individual, i shqyrtoi shkresat e lëndës, aktvendimin e ankimuar dhe pretendimet ankimore, në kuptim të nenit 194 e 208 të Ligjit

për Procedurën Kontestimore (LPK), e lidhur me nenin 3 paragrafi 2 dhe nenin 17 të Ligjit nr.04/L-139 për Procedurën Përmbartimore (LPP) dhe gjeti se:

Ankesa e autorizuarit të kreditorit është e pabazuar.

Nga shkresat e lëndës rrjedh se kreditori "4 M" Sh.P.K., me seli në Prishtinë, Bulevardi "Nënë Tereza" 32-1, nr.5, me datë 17.10.2017, ka paraqitur propozim për përmbartim kundër debitorit "Chelsea Point" L.L.C., me seli në Prishtinë, rr."Tringë Smalji" 12/4, në bazë të dokumenti të besueshëm faturës nr.13-06-001 të datës 17.06.2013, për shumën e përgjithshme të detyrimit prej 23,468.00 Euro, detyrim të cilin e ka precizuar në përgjigje në prapësim.

Përmbartuesi privat Kushtrim Metaj, duke vepruar sipas propozimit për përmbartim të kreditorit me urdhrin P.nr.564/2017 të datës 17.10.2017, ka lejuar përmbartimin, duke vlerësuar se fatura e lëshuar nga kreditori i plotëson kushtet për përmbartim. Kundër këtij urdhri përmbartimor debitori me datë 26.10.2017 ka paraqitur prapësim duke kundërshtuar në tërësi urdhrin përmbartimor, me arsyetimin se fatura mbi bazën e së cilës është lejuar përmbartimi është e parashkruar në kuptim të nenit 355 të LMD-së. Tutje, ka shtuar se kreditori nuk është i autorizuar që të kërkoj përmbartimin ndaj debitorit ngase raporti kontraktual në mes të kreditorit 4 M Group Limited, e cila është shoqëri tregtare e inkuorpuar sipas ligjeve të Mbretërisë së Bashkuar dhe kompanisë tjetër në pronësi të Alan Fox, gjithashtu e inkuorpuar në Angli, çka vërtetohet përmes pagesave të cilat janë bërë në llogari të 4M Group Limited. Po ashtu, ka shtuar se përmbartuesi dhe gjykatat e Kosovës nuk janë kompetente për të vendosur në këtë çështje përmbartimor, ngase vendi i përmbushjes së obligimeve kontraktore, vendi i kryerjes së pagesave dhe vendi i themelimit të kompanive ka qenë Londra, dhe rrjedhimisht me kompetencë për të vendosur janë Gjykata e Mbretërisë së Bashkuar. Në fund, ka theksuar se fatura mbi bazën e së cilës është lejuar urdhri nuk është nënshkruar apo pranuar nga debitori, andaj ka propozuar që të aprovohet prapësimi, ashtu që urdhri për përmbartim të anulohet, si dhe të detyrohet kreditori që debitorit t'ia paguaj të gjitha shpenzimet e procedurale, sipas rregullores mbi tarifatat e avokatëve. Përgjigje në prapësim ka paraqitur i autorizuari i kreditorit me datë 02.11.2017, duke i kundërshtuar të gjitha pretendimet e debitorit, me arsyetimin se nuk qëndron pretendimi se kërkesa që rrjedhë nga fatura është parashkruar ngase afati i parashkrimit është ndërprerë me komunikimi në email mes palëve me datë 1 Prill 2014, me ç'rast debitori ka kërkuar nga kreditori ri-dërgimin e faturave, dhe rrjedhimisht kërkesa për ri-dërgimin e faturave paraqet praninë të borxhit. Ndërsa, ka shtuar se edhe pas kësaj palët janë pajtuar që afati i pagesës së borxhit t'i shtyhet debitorit edhe për 1 vit deri në 1 vit e gjysme, çka konfirmohet përmes komunikimit të palëve me 08 Shkurt 2017, prandaj pretendimet për parashkrim janë të paqëndrueshme. Sa i përket pretendimeve të debitorit lidhur me mungesën e raportit juridik mes këtu palëve, kreditori ka theksuar se të njëjtat janë të pabazuara ngase palët, përkatësisht 4 M Sh.P.K., dhe debitorit Chelsea Point, kanë krijuar raport juridik çka vërtetohet edhe nga faturat e lëshuara për debitorin dhe pagesat e ekzekutuara nga ana e debitorit. Ndërsa, sa i përket pretendimeve lidhur me kompetencën e përmbartuesit dhe gjykatave vendore, ka theksuar se sipas nenit 5.5 të LPP-së, përcaktohet se nëse debitori është person juridik, kompetencë territoriale ka gjykata kompetente ku gjendet selia e debitorit. Po ashtu, kreditori ka

kundërshtuar pretendimet e debitorit lidhur me mungesën e nënshkrimit në fatura dhe pranimit të tyre, duke theksuar se faturat janë dorëzuar përmes emaili ashtu siç parashihet edhe në marrëveshjen në mes palëve. Andaj ka propozuar që prapësimi i debitorit të refuzohet si i pabazuar, të aprovohet shuma e precizuar në përgjigje në prapësim dhe atë në lartësi prej 23,468.00 Euro dhe të mbetet në fuqi urdhri përmbarimor.

Gjykata Themelore në Prishtinë, duke vepruar sipas prapësimit të debitorit, me aktvendimin PPP.nr.998/2017 të datës 28.12.2017, ka aprovuar prapësimin e debitorit dhe ka anuluar urdhrin përmbarimor. Kundër këtij aktvendimi, i autorizuari i kreditorit ka paraqitur ankesë në Gjykatën e Apelit, e cila me aktvendimin Ac.nr.1504/2019 të datës 16.11.2020, e ka aprovuar ankesën e kreditorit dhe lëndën e ka kthyer në gjykatë të shkallës së parë në procedim të serishëm.

Në riprocedurë, Gjykata Komerciale, Dhomat e Shkallës së Parë, Departamenti për Çështje Ekonomike, pas shqyrtimit të provave ka nxjerrë aktvendimin KPPP.nr.831/22 të datës 28.04.2023, me të cilin ka aprovuar si të bazuar prapësimin e debitorit, ka anuluar urdhrin përmbarimor P.nr.564/2017 të datës 17.10.2017 dhe ka përfunduar në tërësi përmbarimin në këtë çështje përmbarimore.

Në arsyetim të aktvendimit të ankimuar Gjykata Komerciale, Dhomat e Shkallës së Parë, Departamenti për Çështje Ekonomik, ka theksuar se pas shqyrtimit të pretendimeve të debitorit të paraqitura në prapësim, përgjigjes së kreditorit, provave që gjenden në shkresat e lëndës, si dhe duke marrë për bazë vërejtjet e Gjykatës së Apelit, në mbështetje të dispozitave të nenit 69 dhe 71 të LPP-së dhe nenit 12 paragrafi 2, të Ligjit Nr. 05/L-118 për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit Nr. 04/L-139 Për Procedurën Përmbarimore, gjeti se prapësimi i debitorit është i bazuar dhe se urdhri përmbarimor duhet të anulohet, ndërsa procedura përmbarimore të përfundohet në tërësi, me arsyetimin se fatura nr.13-06-001 mbi bazën e së cilës është lejuar përmbarim është lëshuar më datë 17.06.2013, arritshmëria për pagesë e së cilës është caktuar në afat prej 60 ditësh nga data e lëshimit të faturës, përkatësisht e njëjta është bërë e arritshme me datë 17.08.2013, ndërsa propozimi për përmbarim në raport me këtë faturë është paraqitur me datë 17.10.2017. Rrjedhimisht, fatura e lartcekur është përfshirë në parashkrim, kjo në përputhje me nenin 355 paragrafi 1 dhe 2 të LMD. Mbi këtë bazë gjykata ka gjetur se prapësimi i debitorit gjenë mbështetje në kuptim të nenit 71 paragrafi 1, pika 1.10 të LPP-së. Gjykata ka vlerësuar se në rastin konkret dokumenti i besueshëm mbi të cilin mbështetet propozimi për përmbarim dhe është lejuar urdhri përmbarimor, është përfshirë në parashkrim, dhe si i tillë nuk mund t'i nënshtrohet përmbarimit, rrjedhimisht edhe urdhri i lejuar nga ana e përmbaruesit duhet të anulohet dhe procedura të përfundohet në tërësi. Tutje gjykata ka arsyetuar se ka pasur parasysh komunikimet e palëve përmes email mbi të cilat kreditori pretendon se është ndërprerë parashkrimit për shkak të pohimit të borxhit, mirëpo nga vlerësimi i këtyre komunikimeve nuk rezulton të jetë pranuar borxhi nga ana e debitorit, rrjedhimisht gjykata vlerëson se nuk kemi të bëjmë me ndërprerje të parashkrimit, në kuptim të nenit 368 të LMD-së, po ashtu gjykata ka arsyetuar se kërkesat e përfaqësuesit të kreditorit drejtuar debitorit me datë 03.07.2017 përmes emailit për shlyerjen e detyrimit nuk paraqesin ndërprerje të parashkrimit kuptim të nenit 374 të LMD-së. Në anën tjetër, sa i përket

pretendimeve se debitori e ka kontaktuar në telefon dhe ka kërkuar shtyrjen e afatit për pagesën e borxhit në emër të faturës dhe se palët janë pajtuar për shtyrje të afatit të pagesës për 1 vit deri në 1 vit e gjysmë, gjykata ka arsyetuar se kreditori nuk ka ofruar prova për të vërtetuar këtë fakt, dhe rrjedhimisht ka gjetur se kërkesa e kreditorit është e parashkruar andaj edhe urdhri përmbarimor duhet anuluar. Tutje gjykata ka arsyetuar se gjatë vendosjes në këtë çështje përmbarimore mori parasysh sugjerimet e gjykatës së shkallës së dytë lidhur me hapjen e seancës me qëllim të vlerësimit të pagesave të realizuara dhe barazimit të borxhit, mirëpo, meqë gjykata gjeti se kërkesa e kreditorit është përfshirë në parashkrim, në mbështetje të nenit 73 të LPP-së, vendosi jashtë seancës.

Gjykata Komerciale – Dhomat e Shkallës së Dytë vlerëson se aktvendimi i ankimuar nuk është përfshirë me shkelje qenësore të dispozitave të procedurës kontestimore të parashikuara me nenin 182 par.2 të LPK, për arsye se aktvendimi i ankimuar është i kuptueshëm, i qartë dhe përmban arsye bindëse faktike dhe juridike mbi faktet vendimtare kështu që mund të hetohet dhe vlerësohet ligjshmëria e tij, e të cilat shkelje kjo gjykata i heton sipas detyrës zyrtare në bazë të nenit 194 të LPK. Për shkak të zbatimit të rregullt të dispozitave të procedurës përmbarimore dhe për shkak të vërtetimit të rregullt dhe të plotë të gjendjes faktike, e cila nuk vihet në dyshim me asnjë pretendim ankimor, Gjykata Komerciale – Dhomat e Shkallës së Parë drejtë ka vendosur kur e ka pranuar si të bazuar prapësimin e debitorit duke e anuluar urdhrin përmbarimor P.nr.564/2017 të datës 17.10.2017.

Gjykata Komerciale - Dhomat e Shkallës së Dytë vlerëson se nuk qëndrojnë pretendimet ankimore të autorizuarit të kreditorit lidhur me gjendjen faktike si dhe ato lidhur me parashkrimin e borxhit, pasi që sipas vlerësimit të kësaj gjykate me dispozitën e nenit 355 paragrafi 1 dhe 2 të Ligjit për Marrëdhëniet e Detyrimeve është përcaktuar se: *“Kërkesat reciproke nga kontratat komerciale si dhe kërkesat e shpërblimit të shpenzimeve të bëra lidhur me këto kontrata, parashkruhen për tri (3) vite. 2. Parashkrimi rrjedh veç e veç për çdo dërgim të mallit, pune ose shërbimi të kryer”*, e në rastin konkret kemi të bëjmë me dokument të besueshëm – faturë e cila është lëshuar me datë 17.06.2013, kurse propozimi për përmbarim është parashtruar me datë 17.10.2017, me çka afati i parashkrimit ka filluar të rrjedhë, i njëjti është paraqitur pas kalimit të afatit ligjor prej 3 vite brenda të cilit kreditori ka të drejtë që të kërkoj borxhin, andaj në kuptim të dispozitës së lartcekur edhe qëndrimi dhe përfundimi juridik i Gjykatës Komerciale – Dhomat e shkallës së Parë mbi aprovimin e prapësimin të debitorit është i drejtë dhe i ligjshëm.

Andaj nga të cekurat kjo gjykatë e pranon përfundimin juridik të Gjykatës Komerciale – Dhomat e Shkallës së Parë në tërësi, ndërsa sa i përket pretendimeve të kreditorit, kjo gjykatë i analizoi të njëjtat por vlerësoi se nuk ishin relevante për të vendosur ndryshe sepse nuk janë të argumentuar

me prova konkrete ashtu siç parasheh neni 69 paragrafi 4 i LPP-së, ashtu që i refuzoi si të pabazuara.

Kompetenca e Gjykatës Komerciale, Dhomat e Shkallës së Dytë për të vendosur nga ana e gjyqtarit individual në shkallë të dytë bazohet në dispozitën e nenit 3 paragrafi 2 të LPP-së, me të cilën është paraparë se në shkallën e dytë vendimet i nxjerr gjykatësi individual.

Nga sa u tha me lartë u vendos si në dispozitiv të këtij aktvendimi në kuptim të nenit 209 paragrafi 1, pika b) të Ligjit për Procedurën Kontestimore, lidhur me nenin 17 të Ligjit të Procedurës Përmbarimore.

GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS
Dhomat e Shkallës së Dytë
K.DH.SH.II.nr.1024/2023, me datë 02.11.2023.

Gjyqtari,
Ramush Bardiqi